



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2022

Nëntor 2021



©Akademia e Drejtësisë 2021, Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Plani i punës dhe i Performancës është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë me datën 30.11.2021

Tabela e përmbajtjes

1. Lista e shkurtesave	6
2. Hyrje	7
3. Përmbushja e Planit për vitin 2021 dhe sfidat gjatë realizimit të tij	8
Rëndësia e Planit të Punës për vitin 2022	9
Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë	9
Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	10
Këshilli Drejtues	10
Këshilli Programor.....	10
Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.....	11
Objektivat e Planit të Punës për vitin 2022.....	11
Objektivi I: Aftësimi dhe përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar ne trajnimin fillestar përshtatshëm me kompetencat dhe detyrat ne ushtrimin e funksionit përkatës.....	12
1.1 Zbatimi i trajnimit praktik për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit	12
1.2 Zbatimi i trajnimeve praktike në institucione tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar	13
1.3 Zhvillimi i programeve trajnuese për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.....	13
Objektivi II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor në shkathësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare.	14
2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të specializuara për luftimin e formave të korrupsionit, krimit të organizuar, krimit kibernetik, krimet e luftës si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore;	15
2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve	15
2.3 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile.....	16
2.4 Zbatimin e trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK .	16
2.5 Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion.....	17

2.6 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive.....	17
2.7 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	17
2.7.1 Zbatimi i trajnimeve nga modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor	18
2.7.2 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me gjyqtarë, prokuror si dhe bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor	18
2.7.3 Zbatimi i kurrikulës trajnuese të planifikuar sipas programit trajnues për vitin 2022 për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	18
Objektivi III: Ngritja dhe avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të zyrtareve ne profesioneve të lira.....	19
Objektivi IV: Rritja e cilësisë së programeve trajnuese, kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese	19
4.1 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese.....	19
4.2 Zhvillimi dhe avancimi i veprimtarisë botuese.....	20
4.3 Përditësimi dhe pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, bazës së të dhënave dhe përmirësimi i analizave dhe statistikave	20
4.4 Ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së	20
Objektivi V: Përditësimi dhe avancimi i metodologjisë trajnuese sipas standardeve dhe metodave më bashkëkohore	21
5.1 Hartimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë	21
5.2 Programi për Trajnim të Trajnues (TiT)	21
5.3 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	22
Objektivi VI: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.	22
Objektivi VII: Ngritja e transparencës dhe marrëdhënieve me publikun	24
Objektivi VIII: Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve nga departamenti për administratë dhe financa.....	25
Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së	28

1. Lista e shkurtesave

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

EIFL - Electronic Information for Libraries

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PST-Programi i Specializuar i Trajnimit

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

2. Hyrje

Akademia e Drejtësisë është institucion i veçantë në sistemin e drejtësisë veçanërisht për fuqizimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë edhe profesionistët tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Për të siguruar punë efikase në ofrimin e trajnimeve dhe shërbimeve tjera të përcaktuara me Ligjin për AD-në për përfituesit e saj, Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2022, në të cilin plan janë paraqitur objektivat dhe dinamika e arritjes së këtyre objektivave për këtë vit.

Qëllimi i hartimit të këtij plani është përcaktimi i qartë i aktiviteteve në zbatim të programeve të AD-së duke u bazuar në performancën e deritanishme, resurset dhe kapacitetet tjera që ka ky institucion duke përfshi edhe zhvillimet e reja në legjislacion.

Plani i punës është hartuar në pajtim me objektivat strategjike të Programit Trajnues Kornizë (2021-2022) si dhe prioritetet në nivel nacional në fushën e drejtësisë, duke përfshi edhe politikat dhe masat e dala nga strategjia për sundimin e ligjit. Gjithashtu vlejné të përmendet se ky plan do të zbatohet në përputhje të plotë me udhëzimet e parapara për situatën e krijuar pas përhapjes së pandemisë Covid-19.

Në strukturën e planit janë pasqyruar në hollësi, aktivitetet që do të realizohen në kuadër të secilit departament dhe divizion duke përfshirë periudhën kohore dhe veprimet që do të merren për realizimin e këtyre aktiviteteve, njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre si dhe treguesit apo indikatorët që do të mundësojnë matjen dhe monitorimin e përmbushjes së rezultateve.

Për realizimin e Planit të Punës, AD ka përgatit planin e veprimit për zbatimin e të gjitha aktiviteteve si të planifikuara dhe pasqyruara në përshkrimin e secilës objektivë.

3. Përmbushja e Planit për vitin 2021 dhe sfidat gjatë realizimit të tij

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2021 në masë të konsiderueshme janë realizuar konform Planit të punës për vitin 2021 dhe objektivave të përcaktuara në këtë plan. Përderisa për vitin 2020 situata pandemike ishte sfiduese, në vitin 2021 edhe pse në rrethanat e njëjta, është menaxhuar suksesshëm zbatimin e trajnimeve online për gjyqtarë dhe prokurorë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial falë përvetësimit dhe shkathtësive të fituara të zyrtarëve përgjegjës në aplikimin e platformës ZOOM e gjithashtu edhe zbatimin e aktiviteteve tjera të parapara në këtë plan.

Trajnimet e vazhdueshme janë realizuar sipas kalendarit trajnues në formën online dhe në mënyrë të kombinuar ndërkaq trajnimet fillestare me praninë fizike meqë numri i pjesëmarrësve ishte i mjaftueshëm për të siguruar distancën për mbrojtje nga COVID 19.

Procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është realizuar me sukses sepse janë përfshirë gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke konsumuar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili është analizë e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2022 që njëkohësisht prezanton ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces.

Në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti, edhe pse ka pasur vështirësi dhe vonesa plani i prokurimit është realizuar në përgjithësi.

Gjatë vitit 2021 përkundër iniciativës së ndërmarrur nga Ministria e Drejtësisë dhe Akademia e Drejtësisë në zhvillimin e konceptit të dokumentit për fuqizimin e AD nëpërmes grupit punës, Qeveria me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka vazhduar me zbatimin e procesit të racionalizimit të Agjencive të Pavarura në kuadër të cilit proces është përfshirë edhe Akademia e Drejtësisë. Këto zhvillime padyshim se ishin sfiduese për AD-në në përpjekjet për fuqizimin dhe ruajtjen e pavarësisë institucionale të AD-së. Janë zhvilluar debate brenda për brenda AD-së dhe në takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues janë shprehur qëndrimet se AD duhet të qëndrojë si institucion i pavarur dhe se amandamentet ligjore si të propozuara nga qeveria e të përfshira në draft Ligjin për Racionalizimin e Agjencive të Pavarura e që ndërliqhen me Akademinë e Drejtësisë të tërhiqen.

Vizioni dhe misioni

Akademia e Drejtësisë është institucion shtetëror i edukimit dhe aftësimit, i

përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, faktor kyq për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që duhet të gëzojë besimin e publikut.

Akademia e Drejtësisë ofron trajnime cilësore për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, harton analiza, zhvillon hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe standardet e mira ndërkombëtare.

Rëndësia e Planit të Punës për vitin 2022

Plani i Punës është një dokument i rëndësishëm përmes të cilit pasqyrohen saktë aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit në funksion të përmbushjes së nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe mandatit të Akademisë së Drejtësisë të përcaktuar me ligj. Ky dokument gjithashtu shfaqë resurset brenda institucionit të cilat duhet të angazhohen, proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve. Në përmbushjen e Planit të Performancës, AD vëmendje të veçantë do t'i kushtoj menaxhimit të punës, bashkërendimit të aktiviteteve si dhe bashkëpunimit i cili duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve. Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet në baza javore dhe mujore me qëllim që të mos ketë ngecje në përmbushje, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat e përcaktuara në këtë plan.

Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për AD-në, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionve tjera të lira përmes zbatimit të trajnimeve dhe zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe materialeve tjera ligjore.

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë si dhe aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, dhe atë si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;

- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

Organet e Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues si organ më i lartë i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2021 do të fokusohet në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Procedurat dhe Standardet për publikim
- Iniciativën për rregullimin e statusit të punësuarve në AD përshtatshëmrisht me stafin e gjykatave dhe prokurorive
- Projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë
- Raporti vjetor për vitin 2021
- Formimin e komisioneve për revistat e AD-së dhe nevojat tjera që dalin për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Listën e mentorëve
- Kërkesat e KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që sapo emërohen;
- Emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues dhe organeve tjera
- Programin Trajnues dhe Planit e Performancës për vitin 2022 si dhe çështje tjera që dalin gjatë vitit 2021.

Këshilli Programor

Këshilli Programor si organ profesional për vitin 2022 do të angazhohet për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara si dhe programet trajnuese. Lidhur me këtë do të fokusohet në çështjet si në vijim:

- Shqyrtimin e listës së trajnuesve dhe mentorëve dhe mendim për listën e trajnuesve potencial për Këshillin Drejtues
- Sigurimin e kualitetit të programeve trajnuese përmes orientimit të

- metodave dhe teknikave trajnuese si dhe do të
- Përcjellë e realizimit e programeve dhe suksesin e tyre.

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë do të fokusohet në prioritet: si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Do të siguroj zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
- propozon projektbuxhetin vjetor të Akademisë;
- Propozon programin e punës dhe programin trajnues të Akademisë;
- Propozon listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista do të caktoj trajnuesit për zbatim të programit;
- Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Propozimin e Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Akademisë, Projekt Rregulloren mbi përzgjedhjen e trajnuesve.

Objektivat e Planit të Punes për vitin 2022

1. Aftësimi dhe përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në trajnimin fillestar përshtatshëm me kompetencat dhe detyrat në ushtrimin e funksionit përkatës;
2. Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor në shkathtësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare;
3. Ngritja e kapaciteteve profesionale e profesioneve të lira;
4. Rritja e cilësisë së programeve trajnuese, kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese;
5. Rishikim dhe zhvillim i programeve trajnuese të AD-së;
6. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

7. Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa
8. Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun

Objektivi I: Aftësimi dhe përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar ne trajnimin fillestar përshtatshëmrisht me kompetencat dhe detyrat ne ushtrimin e funksionit përkatës

Bazuar në Programin Trajnues Kornizë (2021-2022) dhe Programin e Trajnimit Fillestar për gjeneratën e VIII-të, të gjyqtarëve të sapo emëruar do të vazhdojë realizimi i sesioneve trajnuese për 24 gjyqtarët e kësaj gjenerate. Këto sesione janë nga moduli penal i cili përfshinë aspektin e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar. Ndërsa Akademia e Drejtësisë ne baze zhvillimeve dhe planifikimit te rekrutimit nga ana e KGJK dhe KPK për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj ka ndërmarrë te gjitha masat e nevojshme të zhvilloj programet trajnuese për gjeneratat e radhës e qe pritet te jene 54 gjyqtar te ri dhe 16 prokurore të ri.

Programi i Trajnimit Fillestar për vitin 2022, do të fokusohet në objektivat specifike si në vijim:

1. Zbatimin e trajnimit praktik për 24 gjyqtaret në gjykata për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit.
2. Zbatimin e trajnimeve praktike për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar në institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore;
3. Zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve (54) dhe (16) prokurorëve të rinj.

1.1 Zbatimi i trajnimit praktik për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit

Programi i Trajnimit Fillestar do të angazhohet në zbatimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit praktik për modulet në penale në gjykatat përkatëse për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII. Për zbatimin e trajnimit praktik do të angazhohen mentorë nga radhët e gjyqtarëve dhe me përvojë të cilët do të mentorojnë pjesën praktike të programit dhe do të bashkëpunojnë me Akademinë e Drejtësisë për arritjen e objektivave dhe zbatimin me sukses të këtij trajnimi.

Bazuar në strukturën e programit pjesa praktike do të realizohet në 5 ditë të javës fillon në dhjetor të vitit 2021 dhe mbaron në javën e dytë të muajit mars 2022.

1.2 Zbatimi i trajnimeve praktike në institucione tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore për gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar

Në kuadër të trajnimeve praktike gjyqtarët e sapo emëruar sipas programit trajnues do të ndjekin edhe trajnime në institucione tjera jashtë gjyqësore, puna e të cilave është e ndërlidhur me punën e gjyqësorit. Institucionet e planifikuara për këtë vit janë:

- Gjykata Kushtetuese
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues
- Dogana e Kosovës
- Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale
- Instituti i Mjekësisë ligjore

Pavarësisht planifikimit sipas këtij programi situata pandemike mund të ndikoj në realizimin dhe zbatimin e këtij programi praktikë.

1.3 Zhvillimi i programeve trajnuese për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet edhe në zhvillimin e programit trajnues fillestar për gjeneratat e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Këtij procesi parapakisht i ka parapri vlerësimi i nevojave trajnuese i cili do të pasojë me finalizimin e përmbajtjes dhe moduleve trajnuese përkatëse. Gjatë vitit 2022, Akademia e Drejtësisë ka ndërmarr te gjitha masat qe të zbatoj trajnimet fillestare për 54 gjyqtarë dhe 12 prokurorë te rinje që do të emërohen së shpejti, pas përfundimit te procesit te rekrutimin nga të dy këshillat .

Ky program do të përmbajë trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, duke përfshirë edhe Acuis Communautaire, KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare si dhe kompetencën interdiscipinare.

Në kuadër të këtij programi për gjyqtarë të sapo emëruar do të realizohen trajnimet nga 6 modulet trajnuese ndërsa për prokurorë 5 module trajnuese duke përjashtuar modulën i cili trajton çështjet ligjore nga fusha civile, administrative dhe ekonomike.

Modulet që do të trajtohen gjenden si në vijim.

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- E drejta civile administrative dhe ekonomike
- Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese

Në përmbajtje të këtyre moduleve trajnuese për gjyqtarët e gjeneratës së IX do të përfshihen rreth 49 nën module trajnuese me rreth 283 sesione trajnuese ndërkaj për prokurorët e gjeneratës së IX do të jenë rreth 47 me rreth 283 sesione trajnuese.

Objektivi II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor në shkathësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare.

Zbatimi i trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial është obligim ligjor që rezulton nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë. Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022 Akademia do të angazhohet në zbatimin e programit i cili reflekton ndryshimet legjislative, rekomandimet e dala nga Strategjia për Sundimin e ligjit si dhe prioritetet tjera në nivel nacional për fushën e gjyqësorit.

Në këtë drejtim për vitin 2022, trajnimet e vazhdueshme do të fokusohen në objektivat specifike si në vijim:

- 2.1 Zbatimin e trajnimeve cilësore të specializuara për luftimin e formave të korrupsionit, krimit të organizuar, krimit kibernetik, krimet e luftës dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore;
- 2.2 Zbatimin e trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- 2.3 Unifikimin e praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile;
- 2.4 Zbatimin e trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK;
- 2.5 Zbatimin e programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion.
- 2.6 Zbatimin e trajnimeve për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive;
- 2.7 Zbatimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të specializuara për luftimin e formave të korrupsionit, krimin të organizuar, krimin kibernetik, krimet e luftës si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore;

Në kuadrin e trajnimeve të specializuara do të realizohen 8 trajnime në çështjet si në vijim:

- PST për Krimin kibernetik
- PST për Shpëlarjen e parave dhe hetimin financiar
- PST për Prokurimin publik
- PST për Krimin e organizuar
- PST për Korrupsionin
- PST për Ekstremizmin, radikalizmin dhe terrorizmin
- PST për Dhunën në familje
- PST për Krimet e luftës

Këto trajnime do të realizohen në dy-tri sesione me kohëzgjatje në total rreth 41 ditë. Përfitues të këtyre trajnimeve do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për krime të rënda, departamentit special, bashkëpunëtor profesional nga gjykata dhe prokuroria – departamenti special si dhe ekspert nga PSRK. Gjithashtu do të përfshihen edhe zyrtarë tjerë ligjor të cilët në faza të caktuara janë pjesë e procedurës gjyqësore si: zyrtarë policor hetues, zyrtarë të NJIF, mbrojtës të viktimave si dhe zyrtarë nga institucione tjera që kanë fushëveprim luftimin e veprave përkatëse.

2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve cilësore është prioritet për Akademinë e Drejtësisë. Në funksion të kësaj do të angazhohë trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistë tjerë ligjor me përvojë dhe performancë të shkëlqyer për gjitha fushat e trajnimit. Zbatimi i trajnimeve do të bëhet përmes metodologjisë së studimit të rasteve dhe metodave tjera trajnimit gjyqësor. Sipas përmbajtjes do të realizohen trajnime nga drejtësia penale, civile, drejtësia për të mitur, të drejtësia administrative, tregtare – komerciale, financiare, mbrojtën e mjedisit, bashkëpunimin ndërkombëtar, KEDNJ, E Drejta Ndërkombëtare dhe e Bashkimi Evropian (BE), E drejta kushtetuese si dhe Kundërvajtëse. Po ashtu edhe trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinore me theks te shkrimi dhe arsyetimi gjyqësor, etika profesionale, komunikimi, menaxhimi i stresit, shkathësitë e përfaqësimit në gjykim, evidenca penale, teknologjia informative si dhe menaxhimi i rasteve dhe fusha të tjera specifike.

AD do të jetë e fokusuar edhe në hartimin e një kurrikule të veçantë trajnuese

për të Drejtën e BE-së në kuadër të cilës do të përfshihen module trajnuese që do të përfshijë fushat kryesore të së drejtës.

Bazuar në përmbajtjen e këtij programi në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme do të realizohen gjithsejtë rreth 81 aktivitete trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë, rreth 15 aktivitete trajnuese nga modulet e trajnimit bazik në fushën penale dhe civile për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor rreth, 11 trajnime për stafin tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial, 12 trajnime për profesionet e lira si dhe 5 trajnime për trajnues. Nga mësimi në distancë do të zhvillohen dhe integrohen në platformë 4 module të reja.

2.3 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile

Programi i trajnimeve të vazhdueshme përveç trajnimeve të lartpërmendura në një pjese të madhe do të përqendrohet edhe në zhvillimin e tryezave e tryezave të cilat nga përfituesit e AD-së konsiderohen si më efikase në unifikimin e praktikës gjyqësore. Këto tryeza do të moderohen dhe udhëhiqen nga gjyqtarë dhe prokurorë të departamenteve në të cilat do të adresohen çështje të ndryshme ligjore sa i përket politikave ndëshkimore, sekuestrimit dhe konfiskimit, në çështjet familjare me theks të dhuna në familje, çështjet nga procedura përbarimore, kontestimore, pronësore, mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, mbrojtja gjyqësore në rastet e pengim posedimit dhe servituteve, ndërmjetësimi në çështje civile si dhe çështje tjera për të cilat praktika gjyqësore ka vështirësi dhe zvarritje në zgjidhjen ligjore.

Pas tryezave planifikohet nxjerrja e konkluzioneve të cilat do të kenë impakt në hartimin e doracakëve, udhëzuesve dhe formave tjera të materialeve ligjore të cilat do të lehtësojnë procesin e punës në gjykata dhe prokurori. Bazuar në përmbajtjen e programit trajnues janë planifikuar 14 tryeza.

2.4 Zbatimin e trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK

Akademia e Drejtësisë do të jetë e angazhuar në zbatimin e trajnimeve të detyrueshme që janë rezultat i obligimeve ligjore dhe akteve nën ligjore të KGJK-së dhe KPK-së si dhe kërkesave të veçanta nga këto dy këshilla të cilat rezultojnë nga vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Bazuar në Rregulloren për trajnime të KGJK-së dhe KPK-së, AD ka përfshirë në kurikulën e saj etikën profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët. Trajnimet e tjera të detyrueshme sipas KGJK-së dhe KPK-së të cilat derivojnë nga vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ofrohen në koordinim me këto institucione. Lidhur me këtë, Akademia e Drejtësisë ka hartuar protokolin

për trajnime të detyrueshme dhe trajnime shtesë për prokurorët e shtetit e cila mbetet të zbatohet sipas kërkesave gjatë vitit nga KPK.

Qëllimi i këtij Protokoli është të përcaktojë procedurat dhe obligimet për realizimin e trajnimeve shtesë dhe trajnim të detyrueshëm për prokurorë, performanca e të cilëve është vlerësuar me “Pamjaftueshëm”

2.5 Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion

Zbatimi i trajnimeve për avancim është obligim ligjor i AD-së dhe do të realizohet sipas nevojave të KGJK-së dhe KPK-së. Këto trajnime sipas mandatit parashihen në rastet kur gjyqtarët dhe prokurorët kanë kaluar nga niveli më i ulët në nivel më të lartë në gjykatë dhe prokurori, nga një departament në departamentin tjetër si dhe nga niveli i prokurorisë së apelit në zyrën e kryeprokurorit të Shtetit. Këto trajnime kanë për qëllim ofrimin e programeve orientuese-aftësuese, për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe avancimin e tyre profesional, lidhur me përgjegjësitë e reja të funksionit dhe nivelit në të cilin kanë kaluar. Duke u bazuar në Programin Trajnues Kornize (2021-2022) kurikula trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar do të përfshijë module nga kompetenca profesionale dhe ndërdisiplinore duke i njoftuar me specifikat e detyrave të reja me të cilat janë ngarkuar, hierarkinë institucionale, praktikat më të mira të shënuara dhe zhvillimin e shkathtësive të veçanta për kompetencat që i përkasin funksionit të ri.

2.6 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive

Në Programin Trajnues Kornize për vitin 2021-2022 janë paraparë edhe trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive. Akademia e Drejtësisë do të organizojë trajnime specifike për këtë kategori përfituese, në pajtim me politikat dhe standardet e aplikueshme si dhe kërkesat ligjore, por gjithmonë duke ju referuar problemit praktik në ofrimin e ekspertizës për këtë fushë e cila është sfidues për AD-në. Për kundër sfidave, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet ti zbatojë këto trajnime meqenëse janë prioritet edhe nga rishikimi funksional.

2.7 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë obligim ligjor për Akademinë e Drejtësisë dhe në këtë drejtim, Akademia është angazhuar në zhvillimin e programeve trajnuese sipas profileve dhe detyrave të punës. Bazuar

në Programin Kornizë 2021-2022, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në objektivat si në vijim:

- Zbatimin e trajnimeve nga modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor;
- Zbatimin e trajnimeve sipas aplikimit për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe stafi tjetër profesional;
- Zbatimin e kurrikulës trajnuese të planifikuar sipas programit trajnues për vitin 2022 për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

2.7.1 Zbatimi i trajnimeve nga modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor

Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor duke përfshirë aspekte nga e drejta materiale dhe procedurale si në fushën penale ashtu edhe në fushën civile. Fokusi thelbësor do të jetë në përfshirjen e gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në gjykata dhe prokurori në këto trajnime për të ngritë cilësinë e tyre në përgatitjen e vendimeve dhe shkresave tjera ligjore në ndihmë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2.7.2 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me gjyqtarë, prokuror si dhe bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet që të përfshijë bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor që kanë vijuar trajnimet nga modulet e trajnimit bazik në trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Kjo do të bëhet përmes mundësisë së aplikimit ngjashëm sikurse gjyqtarët dhe prokurorët. Gjithashtu vëmendje të veçantë do të kenë ngritja e kapaciteteve të ekspertëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të Prokurorisë Speciale veçanërisht përfshirja e tyre në trajnime në tematikat për të cilat ka juridiksion kjo prokurori.

2.7.3 Zbatimi i kurrikulës trajnuese të planifikuar sipas programit trajnues për vitin 2022 për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Në kuadrin e trajnimeve të planifikuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial do të realizohen 11 trajnime të cilat përfshijnë module trajnuese nga kompetenca profesionale dhe interdiscipinare.

Objektivi III: Ngritja dhe avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të zyrtareve ne profesioneve të lira

Në vazhden e bashkëpunimit me institucionet e profesioneve të lira, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të ofrojë trajnime për përmbaruesit privat, zyrtarët e ANJIF, mbrojtësit e viktimave si dhe sipas kërkesave dhe nevojave për trajnime të avokatëve shtetëror. Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të mundësoj pjesëmarrjen e tyre në trajnimet e vazhdueshme bashkë me gjyqtarët dhe prokurorët. Për vitin 2022 janë planifikuar tri trajnime për përmbarues privat, katër trajnime për mbrojtësit e viktimave si dhe pesë trajnime për zyrtarët e Agjencinë për ndihmë juridike falas dhe zyrtarët e OJQ-ve që me punën e tyre ofrojnë ndihmë juridike falas për qytetarët.

Objektivi IV: Rritja e cilësisë së programeve trajnuese, kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese

Hulumtimet dhe botimet në fushën juridike janë gjithashtu mandat ligjor për Akademinë e Drejtësisë dhe në këtë vështrim bazuar në Programin Kornizë për vitin 2021-2022 programi i PHP-së për vitin 2022 do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 4.1 Zbatimin e procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2023;
- 4.2 Zhvillimin e veprimtarisë botuese;
- 4.3 Përditësimin dhe pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës elektronike, dhe përmirësimin e analizave dhe bazës së të dhënave si dhe;
- 4.4 Ofrimin e burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së.

4.1 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese

Zhvillimi dhe hartimi i programeve trajnuese bazohet në zhvillimin e një procesi paraprak të vlerësimit të nevojave trajnuese të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ky proces është i një rëndësie të veçantë meqë i paraprin përcaktimit të kurrikulës trajnuese prandaj edhe do të filloj krahas zbatimit të programit trajnues për vitin 2022 duke zbatuar mekanizmat për vlerësim dhe duke përcjellë zhvillimet në gjyqësor gjatë gjithë vitit.

Në procesin për vlerësimin e nevojave trajnuese do të përfshihen gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke përfshirë edhe trajnuesit e AD-së në analiza dhe hulumtime që i kontribuojnë zhvillimit të programit adekuat me nevojat trajnuese. Në këtë proces do të angazhohen përveç njësisë së PHP-së

edhe përgjegjësit e programeve trajnuese, për të kontribuar me rekomandimet nga pyetëtorët por edhe në zhvillimin e aktiviteteve tjera në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese.

4.2 Zhvillimi dhe avancimi i veprimtarisë botuese

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë botuese e realizon përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime, dhe gjatë vitit 2022 do të angazhohet në nxjerrjen e revistave juridike *Justicia* dhe *Opinion Juris*. Mungesa e kuadrit ligjor respektivisht zhvillimi i procedurave standarde dhe kriterëve për publikim mbetet një sfidë në vazhdim për Këshillin Drejtues edhe për gjatë vitit 2022. Zhvillimi dhe publikimi i revistave në fjale synon përmirësimin e cilësisë së punimeve veçanërisht duke senzibilizuar aspektin krahasimor dhe praktikën gjyqësore përmes kriterëve dhe standardeve të avancuara për publikim. Vëmendje të veçantë do të kenë edhe zhvillimi i moduleve trajnuese bazuar në kriteret dhe standardet që do të përcaktohen për publikim, zhvillimi i doracakëve për praktikën gjyqësore në fusha të ndryshme.

4.3 Përditësimi dhe pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, bazës së të dhënave dhe përmirësimi i analizave dhe statistikave

Biblioteka elektronike do të jetë prioritet për Akademinë e Drejtësisë. Ajo do të pasurohet edhe më tutje me burimet juridike të reja qofshin ato botime të AD-së apo edhe botime tjera juridike të cilat kanë relevancë për gjyqësorin dhe që AD ka pëlqimin apo të drejtën e publikimit. Vëmendje të veçantë do ti kushtohet vazhdimit të abonimit në data baza përmes vazhdimit të anëtarësimit në ABEK.

Në kuadrin e statistikave do të vazhdohet me integrimin dhe përditësimin e të dhënave lidhur me aktivitetet trajnuese duke shërbyer si burim kryesor efikas i informatave për nevoja të raportimit institucional qoftë në KGJK, KPK për gjyqtarë, prokurorë dhe përfituesit tjerë sipas ligjit ashtu edhe për institucione tjera dhe organizma ndërkombëtarë që monitorojnë sistemin e drejtësisë.

4.4 Ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së

Programi për hulumtime dhe publikime do të vazhdojë të jetë në shërbim të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit përmes bibliotekës ligjore dhe burimeve juridike që ofron kjo bibliotekë për përfituesit e AD-së. Për çdo zhvillim apo edhe burime të reja do t'iu mundësohet shfrytëzimi i tyre përmes ofrimit të qasje dhe ofrimit të linqeve për formatin elektronik si dhe ekzemplarët në kopje fizike. Kjo bibliotekë do të operojë përmes dy platformave elektronike, sistemit informativ të bibliotekës që njihet si sistemi KOHA dhe

platformës së E PRINTIT që ndryshe quhet E Biblioteka apo edhe biblioteka elektronike.

Biblioteka përmban afërsisht rreth 1600 tituj që përfshinë enciklopedi, fjalorë, gazeta zyrtare, ligje komentare, libra akademikë që trajtojnë çështje ligjore, doracakë të ndryshëm, artikuj nga revista të ndryshme etj, të cilat do të jenë në shfrytëzim të përdoruesve të bibliotekës sipas kërkesave për studim dhe hulumtim të përfituesve të AD-së.

Objektivi V: Përditësimi dhe avancimi i metodologjisë trajnuese sipas standardeve dhe metodave më bashkëkohore

Zhvillimi i metodologjisë trajnuese do të jetë prioritet për AD-në e cila do të arrihet përmes zhvillimit të Programit të trajnimit të trajnuesve. Objektivi kryesor e këtij programi do të jenë:

- 5.1 Hartimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë;
- 5.2 Zbatimi i trajnimit për trajnues si dhe
- 5.3 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

5.1 Hartimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë

Akademia e Drejtësisë do të orientojë programin trajnues në ngritjen e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies si dhe avancimin e teknikave për aplikimin e metodologjisë moderne trajnuese. Vëmendje e posaçme do të kushtohet edhe ndryshimeve në infrastrukturën ligjore sa i përket standardeve dhe mënyrës së përzgjedhjes së trajnuesve dhe mentorëve. Hartimi i programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë do të bëhet në bashkëpunim me OPDAT i cili do të mbështet me ekspertizë ndërkombëtare.

5.2 Programi për Trajnim të Trajnues (TiT)

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022, Akademia e Drejtësisë për vitin 2022 do të realizojë afërsisht 5 trajnime të trajnuesve të cilat do të jenë rezultat i bashkëpunimit me projektet me donatorë. Trajnimet do të përqendrohen në trajtimin e këtyre fushave: Ndërmjetësimin, krimin kibernetik, lufta kundër dhunës ndaj grave/dhunës në familje, konfiskimi si dhe pastrimi i parave pa vepër bazë. Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e tyre do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse.

Këtyre aktiviteteve i paraprijnë rekrutimi i trajnuesve i cili do të bëhet me një proces transparent përmes konkursit të hapur.

5.3 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2022 do të ofroj trajnime edhe përmes platformës së mësimi në distancë. Përveç kurseve të zhvilluara më parë do të zhvillohen edhe kurse të reja trajnuese të cilat do të integrohen në platformë dhe do të jenë të çasshme në të dy gjuhët (Shqip dhe Serbisht). Tematika që do të ofrojnë këto kurse janë: Paraburgimi, markat tregtare, patentat, dizajni industrial, sekuestrimi dhe konfiskimi, kundërkorrupcioni (sipas ndryshimeve legjislative) si dhe parandalimi i torturës nga platforma HELP e Këshillit të Evropës.

Objektivi VI: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Në kuadrin e përgjegjësisë së përbashkët për fuqizimin institucional të gjykatave dhe prokurorive, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në këto objektiva specifike:

- 6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës
- 6.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë
- 6.3 Avancimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare
- 6.4 Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në bashkëpunimin e mëtejshëm ndërinstitucional me KGJK dhe KPK, Gjykata dhe Prokurori për zbatimin e programeve trajnuese. Fokusi i bashkëpunimit do të orientohet në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas nevojave dhe trajnimet e detyrueshme sipas vlerësimit të performacës dhe kërkesave nga KGJK dhe KPK. Vëmendje të veçantë do të kushtohet kordinimit me gjykatat dhe prokurorit për zbatimin e trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu ky bashkëpunim do të fokusohet edhe në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të këtyre institucioneve dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve tjera në interes të përbashkët.

Bazuar në kërkesat e rishikimit funksional dhe strategjisë për sundimin e ligjit, Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë do ti kushtoj bashkëpunimit me KGJK dhe KPK për zbatimin e masave të përbashkëta të planifikuara për vitin 2022 sipas këtyre dokumenteve strategjike.

6.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Akademia e Drejtësisë për të fuqizuar edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional edhe gjatë vitit 2022 do të vazhdojë në zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e sistemit të drejtësisë e po ashtu edhe me organizata që kanë fokus sundimin e ligjit. Marrëveshjet e arritura janë me institucionet si në vijim: Akademinë e Sigurisë Publike, Shoqatën e Sigurimeve, Qendrën e trajnimeve dhe burimeve për avokim, Odën e përmbauesve Privat, Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës “ Isa Buletini”, Chechi & Company Consulting, Initiative for Justice and Equality (INJECT), GIZ si dhe UNHCR. Këto marrëveshje bashkëpunimi do të konkretizohen me programe të trajnimit të koordinuara dhe të balancuara për kategoritë përkatëse, në shkëmbimin e informatave të dala nga trajnimet, shkëmbimin e informacioneve dhe materialeve profesionale dhe akademike, zhvillimin e kurrikulave trajnuese dhe formave tjera.

Vëmendje të veçantë Akademia e Drejtësisë do ti kushtoj bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht grupin punues për hartimin e projektligjit të ri për Akademinë e Drejtësisë.

6.3 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare

Gjatë vitit 2022, Akademia synon të jetë në projekte të përbashkëta ndërkombëtare për zhvillim të gjyqësorit e po ashtu edhe nismave të ndryshme rajonale e më gjerë të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një gjyqësori profesional. Akademia do të mundësojë trajnuesve dhe veçanërisht përfituesve të saj pjesëmarrjen në forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme të cilat kanë në fokus avancimin e trajnimit gjyqësor si dhe sundimin e ligjit.

Gjatë vitit 2022 do të bashkëpunoj veçanërisht me OPDAT, USAID, INL EJTN, IRZ-EUKOJUST, JUFREX, PECK III, SAEK, UNDP, GIZ, IRZ, UNHCR, EULEX, OSBE, Mbështetja e BE-së për Sistemin e të Drejtave Pronësore

Intelektuale në Kosovë si dhe iniciativat regjionale të mbështetura nga KE dhe BE .

Në kuadër të bashkëpunimit me këta mekanizma do të realizohen trajnime dhe aktivitete tjera në fushën e luftimit të korrupsionit, hetimeve financiare, mbrojtjes së të drejtave të njeriut me theks të neni 3 dhe 10 i KEDNJ-së, drejtësinë komerciale, krimet e luftës, ndërmjetësimin, evidenca penale si dhe në fusha tjera relevante për gjyqësorin.

6.4 Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim të planifikimit dhe zbatimit të politikave euro integruese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendore në zbatimin e masave dhe aktiviteteve në përmbushje të agjendës evropiane. Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e masave të përcaktuara për vitin 2022 të cilat reflektojnë kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe mekanizmave tjerë euro integrues. Në këtë drejtim me mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar duke marrë përgjegjësi në zbatimin e masave për vitin 2022 të cilat kanë qëllim avancimin e sistemit të drejtësisë me theks në luftimin e shpëlarjes së parave, hetimeve financiare, korrupsionit dhe veprave tjera që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin, krimet e luftës dhe dhuna në familje. Në këtë kuadër do të vazhdojë të bashkëpunojë përmes raporteve periodike dhe të dhënave tjera që kërkohen nga mekanizmat përkatës.

Objektivi VII: Ngritja e transparencës dhe marrëdhënieve me publikun

Akademia e Drejtësisë është institucion i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë sepse kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të pasur një sistem gjyqësor të pavarur, efikas dhe që gëzon besimin e publikut. Bazuar në këtë parim edhe për veten e saj është kujdesur që të ndërtojë mekanizma që i kontribuojnë marrëdhënies me publikun. Në këtë drejtim, Akademia vazhdon të fuqizoj edhe më tej besimin e publikut duke bërë transparente veprimtarinë dhe aktivitetet e saj përmes portalit dhe web faqes. Edhe gjatë vitit 2022 do të jetë e përkushtuar edhe më tej që ti bëjë publike gjitha aktivitetet e rëndësishme dhe proceset tjera qoftë përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

Objektivi VIII: Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve nga departamenti për administratë dhe financa

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022 përkatësisht programin trajnues 2022, Departamenti për administratë dhe financa do të fokusohet në zbatimin e politikave zhvillimore brenda kompetencës së vet në mbështetje të Programit trajnues dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadrin e njësive përmes të cilave operon ky departament do të fokusohet në këto objektiva specifike:

- 8.1 Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- 8.2 Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi;
- 8.3 Planifikimin e prokurimit dhe menaxhimin e drejtë të kontratave;
- 8.4 Përdorimi i teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë;
- 8.5 Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022 dhe
- 8.6 Bartja në objektin e ri të Akademisë së Drejtësisë

8.1 Zhvillimi, menaxhimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2022 do të jetë e fokusuar në ofrimin e kushteve më të mira të punës dhe në rritjen e potencialit të tyre. Aktualisht, Akademia e Drejtësisë ka 32 pozita të miratuara prej të cilave 26 janë të plotësuara dhe 6 pozita të tjera janë të lira për shkak të paqartësive ligjore rreth procesit të rekrutimit. Kjo situatë ndikon në procesin e punës dhe në arritjen e objektivave të institucionit. Akademia e Drejtësisë po ashtu do të jetë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore dhe në këtë drejtim do t'i mundësoj stafit ndjekjen e trajnimeve të ndryshme përmes IKAP por jo vetëm, duke siguruar programe adekuate trajnimi, me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.

8.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi

Burim kryesor financiar i Akademisë së Drejtësisë është buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme. Departamenti për Administratë dhe Financa do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara duke vlerësuar koston reale për të gjitha

aktivitetet e përfshira në buxhetim.

Planifikimit buxhetor do ti paraprijnë takimet dhe vlerësimet brenda njësave organizative të cilat luajnë rol të rëndësishëm dhe vendimtar në këtë proces. Planifikimi i mirë dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë realizimin e planit dhe programit të Akademisë.

8.3 Planifikimi i prokurimit dhe menaxhimi i drejtë i kontratave

Bazuar në Ligjin për prokurimin publik, aktivitetet e prokurimit dhe lidhjen e kontratave për Akademinë i realizon AQP. Me këtë ligj ka ndryshuar edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. Megjithatë, në fushën e prokurimit, Akademia do të angazhohet në planet për menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e tyre në harmoni me legjislacionin në fuqi.

8.4 Hartimi i strategjisë zhvillimore për përdorim i teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë

Përdorimi i teknologjisë informative në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera përmes teknologjisë informative do të jetë një ndër objektivat kryesore në fushën e teknologjisë informative. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike që posedon AD-së është një proces i vazhdueshëm i cili kërkon dhe ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje. Në situatën aktuale më shumë se asnjëherë më parë, Akademia e Drejtësisë do të jetë e angazhuar në zhvillimin e teknologjisë informative meqenëse aktivitetet e AD-së do të realizohen përmes platformave të mësimit online.

Divizioni i TI do të vazhdoj në ofrimin e përkrahjes së shërbimeve të TIK-ut për përdoruesit e TI-së në realizimin e objektivave të AD-së. Prioritet do të jetë avancimi i infrastrukturës së TI-së, ngritja e cilësisë të trajnimeve përmes shërbimeve të TIK-ut, avancimi i platformës për mësim në distancë si dhe aplikimi i Office 365 tek të gjithë përdoruesit.

8.5 Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022

Departamenti për Administratë dhe financa do të angazhohet në ofrimin e shërbimeve që mbështesin realizimin e funksioneve kryesore të AD-së, përmes ofrimit të shfrytëzimit të teknologjisë informative, përkthimit, infrastrukturës, furnizimet, transportin, mirëmbajtjen, sistemin elektronik të furnizimeve si dhe klasifikimin dhe arkivimin e dokumenteve.

8.6 Plani i mobilizimit dhe funksionalizimi i objektit të ri të Akademisë së

Drejtësisë

Bazuar në memorandumun e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë si dhe ish Ministrisë së Administratës Publike, tanimë Ministria e Punëve të brendshme ka rezultuar lidhja e kontratës për ndërtimin e objektit të ri të Akademisë së Drejtësisë. Sipas kësaj kontrate ndërtimi i objektit ka filluar në shtator të vitit 2019 ndërkaq është planifikuar të përfundoj në shtator të vitit 2022 dhe të jetë i shfrytëzueshëm nga Akademia e Drejtësisë për të përmbushur veprimtarinë e saj të përcaktuar me ligj.

Gjatë vitit 2022 do të ketë vëmendje të veçantë procesi i bartjes nga objekti aktual në objektin e ri. Lidhur me këtë do të hartohet një plan i detajuar për procesin e bartjes duke i përcaktuar aktivitetet, personat përgjegjës si dhe veprimet tjera që i kontribuojnë këtij procesi.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së

Për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës për vitin 2022, në Planin e veprimit si në vijim do të përcaktohen qartë: objektivat, njësia përgjegjëse, afatet kohore, buxheti si dhe indikatorët apo rezultatet e arritura. Akademia e Drejtësisë do të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial duke përditësuar këtë plan varësisht nga kërkesat që mund të dalin si pasojë e ndryshimeve legjislative apo kërkesave tjera nga autoritetet relevante. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Punës, bëhet përmes procesit të monitorimit i cili realizohet në baza tre mujore. Ky proces mbikëqyrë përmbushjen e indikatorëve si dhe sfidat dhe menaxhimin e rreziqeve.

Në planin me poshtë janë të listuara tetë objektivat madhore të cilat janë në përputhje me nevojat si të pasqyruara me lart në planin e punës. Objektivat janë reale dhe të realizueshme, mirëpo sfide mbetet buxheti për arritjen e objektivave në fjale. AD në kërkesën buxhetore ka kërkuar 1,894,195 euro, ndërsa është aprovuar 660,149 euro, e cila shumë nuk korrespondon me aktivitetet e parapara.

Pavarësisht kërkesës së AD-së dhe nevojës për mjete shtesë sa i përket inventarit për objektin e ri të AD-së, proces ky që është prezentuar në këtë plan dhe pritet bartja nuk është aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Kjo gjendje do të vështirësoj procesin e punës dhe rrjedhimisht edhe aktivitetet e planifikuara.

Planit të performancës për vitin 2022

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
1. Aftësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar si dhe përgatitja profesionale përshtatshëm me rolin dhe detyrat e funksionit përkatës (realizimi i Programit të trajnimit fillestar)	Zbatimi i trajnimit praktik në gjykata për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit si dhe në institucionet e tjera jo gjyqësore	Programi i trajnimeve fillestare (PTF)	Janar – Mars	338,232	BKK	Raporti përfundimtar i hartuar për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të trajnuar për aspektin praktik të moduleve në fushën penale
	Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore	(PTF)	Janar – Mars			Raportet e vlerësimit për punimet hulumtuese
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e radhës (54) gjyqtarëve dhe (16) prokurorëve të rinj.	(PTF)	Janar– Mars Mars- Dhjetor			Programi i hartuar dhe miratuar 54 Gjyqtarë dhe 16 prokurorë të sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit	Zbatimi i trajnimeve cilësore të specializuara	Programi i trajnimeve të vazhdueshme (PTV)	Janar- Dhjetor	198,753	BKK	20 gjyqtarë, 10 prokurorë 3 bashkëpunëtorë profesional dhe 2 ekspert të PSRK-së të trajnuar

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor në shkathtësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare	Zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;	(PTV)	Janar-Dhjetor			300 gjyqtarët dhe 150 prokurorë të trajnuar
	Zbatimi i trajnime interdisciplinare për gjyqtarë dhe prokurorë;	(PTV)	Janar-Dhjetor			40 gjyqtarët dhe 15 prokurorë të trajnuar
	Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile	(PTV)	Janar-Dhjetor			Raporti me konkluzionet nga tryezat i hartuar
	Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	(PTV)	Janar-Dhjetor			Gjyqtar dhe prokurorë të trajnuar për trajnimet e detyrueshme ¹
	Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion	(PTV)	Janar-Dhjetor			Gjyqtarë dhe prokurorë të avancuar të trajnuar sipas kompetencës dhe detyrave përkatëse
	Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	(PTV)	Janar-Dhjetor			500 Bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të trajnuar ² 75 Administratorë,

¹ Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar varet nga vlerësimi i performances dhe nga kërkesat e KGJK dhe KPK. Nëse trajnimet për etikën siq kanë qenë obligative me rregulloret e të dy Këshillave mbeten në fuqi edhe më tej atëherë edhe numri i të trajnuarve mbetet sipas numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistem

² Akademia e Drejtësisë synon ti përfshijë të gjithë bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor në modulet e trajnimit bazik në fushën penale dhe civil, me mbështetjen e donatorëve dhe sipas buxhetit.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
						ndihmës administratorë, shef ZML-së, referentë, zyrtarë të statistikave, sekretarë juridikë, arkivistë, zyrtarë për komunikim dhe media me publikun të gjykatave dhe prokurorive si dhe zyrtarë ligjor dhe zyrtarë nga njësi për vlerësim të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorive sekretarive të KGJK-së dhe KPK-së të trajnuar
3.Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira	Zbatimi i trajnimeve për profesionet e lira	(PTV)		NA		Përmbanues privat, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të ANJF si dhe zyrtarë të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas të trajnuar

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
4. Krijta e cilësisë së programeve trajnuese, kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese	Zbatimin e procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2023	Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)		83,515	BKK	Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese i hartuar
	Zhvillimi i veprimtarisë botuese	PHP	Janar-dhjetor			Revistat dhe botimet tjera juridike të publikuara
	Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, dhe analiza e bazës së të dhënave si dhe ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së	PHP	Janar-dhjetor			Materialet ligjore të publikuara
5. Avancimi i metodologjisë trajnuese si pas standardeve dhe metodave bashkëkohore	Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë	Departamenti Programit (DP)	Janar-dhjetor			Programi i trajnimit për trajnues i hartuar
	Zbatimi i trajnimit për trajnues	DP	Janar - Dhjetor			Gjyqtarë, prokurorë si dhe përfitues tjerë sipas ligjit të trajnuar
	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	DP si dhe njësia e TI-së	Janar - Dhjetor			Kurset e zhvilluara dhe të integruara në platformë si dhe gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë të trajnuar

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
6. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare	Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës	AD	Janar - Dhjetor			Marrëveshjet e nënshkruara/të zbatuara
	Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë	AD	Janar - Dhjetor			
	Zbatimi i projekteve me donatorë	AD	Janar - Dhjetor			Raportet e punës
	Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	AD	Janar - Dhjetor			Raportet e hartuara për mekanizmat përkatës
Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun	Ofrimi i qasjes për palët e interesit	AD	Janar - Dhjetor			Njoftimeve publike, shpalljet dhe aktivitetet tjera të publikuara në portalin e AD-së
Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve të	Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore	Departamenti për Administratë dhe Financa (DAF)	Janar - Dhjetor	221,362	BKK	Plotësimi i pozitave të lira Numri i stafit të AD-së i trajnuar

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
departamentit për administratë dhe financa	Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi	(DAF)	Mars-Tetor			KASH-Buxheti 2023-2025 i hartuar
	Planifikimin e prokurimit dhe menaxhimit të drejtë të kontratave	(DAF)	Janar-Dhjetor			Plani i hartuar dhe i zbatuar
	Përdorimi i teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë	(DAF)	Janar-Dhjetor			Pajisjet funksionale
	Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022	(DAF)	Janar-Dhjetor			Furnizimet dhe shërbimet e pranuar si dhe raporti i hartuar
	Bartja në objektin e ri të Akademisë së Drejtësisë	(DAF)	Shtator-Dhjetor	671,300	BKK	Plani i hartuar dhe fillimi i punës në objektin e ri

Buxheti sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2020 dhe sipas qarkores buxhetore 2022/2 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;

Kategoria	Qarkorja Buxhetore 2022/02 - MFPT	Kërkesa Buxhetore 2022	Difrenca Kërkesa Buxhetore 2022 - Qarkorja Buxhetore 2022/02 - MFPT
Paga dhe Meditje	243,649	364,533	(120,884)
Mallra dhe sherbime	400,000	841,862	(441,862)
Shpenzime Komunale	16,500	16,500	-
Shpenzime Kapitale		671,300	(671,300)
Total Buxheti	660,149	1,894,195	(1,234,046)

9. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban edhe sfida dhe rreziqe, ndër të cilat theksojmë:

- Akademia e Drejtësisë është pjesë e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit që ndikon drejtpërdrejtë në punën e AD-së meqë si proces ende nuk ka përfunduar.
- Rishikimi i legjislacionit për Akademinë e Drejtësisë
- Procesi i transferimit në ndërtesën e re të AD-së paralelisht me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022.
- Buxheti jo i mjaftueshëm për inventarin e objektit të ri të AD-së
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit.
- Procesi i qartësimit të statusit të AD-së përshtatshmërisht me statusin e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial;

- Fuqizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet përgjegjëse, përkatësisht KGJK dhe KPK si dhe kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive për zbatimin e trajnimeve të detyrueshme, trajnimeve shtesë në PTF si dhe për trajnimet bazike për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Forma e re e realizimit të trajnimeve (virtuale), për shkak të pandemisë (mos aplikimi i pajisjeve që vërteton prezencën apo mos prezencën në trajnim);
- Pjesëmarrja jo aktive në trajnimet virtuale;
- Mungesa e trajnuesve të profilizuar;
Mos shfrytëzimi i mjaftueshëm i resurseve të bibliotekës nga ana e përfituesve të AD-së;
- Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- Zhvillimi programit të përhershëm për trajnues;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste.

Akademia e Drejtësisë do të hartoj një regjistër të veçantë ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve

10. Përfundimi

Plani i punës dhe i performancës hartohet me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor të Akademisë së Drejtësisë në mënyrën sa më funksionale duke përfshirë edhe menaxhimin më të mirë të punës së Departamentit të Programit dhe Departamentit të Administratës dhe Financave në funksion të këtij qëllimi. Plani është dizajnuar në atë formë duke iu përshtatur rrethanave të reja ku janë përcaktuar në detaje realizimi i aktiviteteve të programeve si dhe njësive përgjegjëse që operojnë në kuadër të Akademisë së Drejtësisë. Staf i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani duke i marrë në konsideratë veprimet dhe afatet e përcaktuara për çdo aktivitetet të paraparë.

